



Marjola Llanaj

Këshilltar

KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Znj. Marjola Llanaj është Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, me një karrierë mbi 20-vjecare në fushën e auditimit publik dhe zbatimit të ligjshmërisë. Përgjatë karrierës së saj, ajo ka ndjekur një rrugëtim të vazhdueshëm të zhvillimit profesional dhe atij në karrierë në KLSH, duke ndjekur një progres në rritje në të gjitha pozicionet e ndryshme brenda institucionit, nga Auditues i Parë, Drejtuese Grupi Auditimi, Auditues i Lartë, Kryeaudituese, Drejtor Departamenti, deri në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe aktualisht si Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit.

Formimi akademik i saj, përfshin Master Shkencor në Administrim Biznesi dhe Master Shkencor në Shkenca Juridike në Universitetin e Tiranës, duke kombinuar njohuritë e avancuara ekonomike dhe juridike për të ndërtuar një profil të lartë ndërdisiplinor në fushën e auditimit publik. Ky formim ka shërbyer si themel i rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të saj në analizën financiare, ligjore dhe menaxhimit strategjik në Institucion.

Ekspertiza e saj mbulon të gjitha llojet e auditimit, veçanërisht auditimin e përputhshmërisë, auditimin financiar, auditimin e performancës, si dhe auditimin e projekteve të Partneritetit Publik-Privat (PPP), duke reflektuar një qasje të gjithanshme dhe të integruar ndaj auditimit publik dhe mbikëqyrjes së përdorimit të fondeve publike. Puna e saj karakterizohet nga përkushtimi ndaj profesionalizmit, garantimi i transparencës dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të Institucionit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfaqësimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.


Ajo ka udhëhequr auditime në të gjitha nivelet e qeverisjes ku përdoren fonde publike, duke përfshirë auditimin kompleks të Partneritetit Publik-Privat (PPP) dhe projekteve me financim ndërkombëtar, duke zhvilluar dhe zbatuar praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit.


Në rolin e saj si Këshilltare, ajo kontribuon në hartimin e politikave strategjike të Kontrollit të Lartë të Shtetit, këshillimin e lidhshëm të nivelit të lartë dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjive të auditimit publik, duke forcuar gjithashtu kapacitetet teknike dhe profesionale të institucionit.


Znj. Llanaj, gjithashtu është e certifikuar në një sërë programesh profesionale nga institucione prestigjioze brenda dhe jashtë vendit, përfshirë auditimin financiar, auditimin e performancës, auditimin e projekteve ndërkombëtare dhe auditimin e integritetit. Ka përfaqësuar Kontrollin e Lartë të Shtetit në forume të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare si EUROSAI, INTOSAI, IDI, Gjykata Evropiane e Llogarive, etj., ku kjo pjesëmarrje ka shërbyer në implementimin e standardeve moderne të auditimit publik dhe hartimin e praktikave më të mira për forcimin e luftës kundër korrupsionit në vend.



Kontakt

 mlanaj@klsh.org.al

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë
Shqipëri

 www.klsh.org.al